



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.552/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaçi dhe Faton Ademi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Gresa Kasëmi, me vendbanim në Zvicër, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli A.nr.552/2021 i datës 02.03.2021, e paraqitur nga Gresa Kasëmi, me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, pasi që për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 115/2021 të datës 05.02.2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Gresa Kasëmi, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 09.02.2021, me të cilin thekson në mënyrë të pa drejtë i është mohuar e drejta e votimit nga ana e KQZ-së, dhe se emri i saj nuk është në listën e votuesve edhe pse i është përmbajtur me korrektësi dhe afat proceduarve për regjistrim. E njëjta thekson se emailin me konfirmimin nga KQZ-ja e ka pranuar me datën 14.01.2021, dhe se më nuk është kontaktuar nga ana e KQZ me telefon. E njëjta shton se për verifikim ka provuar që ti kontaktoj KQZ-në përmes telefonit dhe mesengerit, por se nuk ka mundur ti kontaktoj.

Paneli, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga Gresa Kasëmi, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar më parë nga parashtruesja e njëjtë e paraqitur me datën 03.02.2021 e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 115/2021 të datës 05.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Gresa Kasëmi është **çështje e gjykuar “res iudicata”**.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 115/2021 të datës 05.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në apel.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 552/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.